



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT
PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke vlerësuar rolin e Avokatit të Popullit si institucion kushtetues i rëndësishëm në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

- Duke vlerësuar rolin e veçantë të Avokatit të Popullit në nxitjen e standardeve më të larta në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, si dhe rolin proaktiv në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në veçanti, të grupeve më vulnerabël në shoqëri;

- Duke vlerësuar rolin e zyrave rajonale të Avokatit të Popullit në promovimin e këtij institucioni dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në gjithë hapësirën gjeografike ku këto zyra operojnë;

Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit, për vitin 2018, lidhur me:

- Rritjen e vëmendjes për respektimin e të drejtave të grupeve të veçanta të marginalizuara si: fëmijët, të huajt etj.

- Dhënien e kontributit në mënyrë proaktive për përmirësimin e legjislacionit vendas, në përmbushje edhe të rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit.

- Dhënien e 171 rekomandimeve, pavarësisht mosplotësimit me kapacitet të plotë, me komisionerë për vitin 2018.

- Rritjen e numrit të çështjeve të inicuar kryesisht.

- Forcimin e bashkëpunimit me institucionet partnere ndërkombëtare.

- Rritjen e vëmendjes së Mekanizmit për Parandalimin e Torturës në respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në komisaritet e policisë, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, në Qendrën e Trajtimit të të Huajve të Parregullt në

Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e ndalimit kufitar, si dhe pikat, të cilat shihen si të mundshme për të ndërtuar qendra të pritjes ose ndihmës për kalimin transit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

- Rritjen e cilësisë së trajtimit të kërkesave dhe ankesave.
- Realizimin e një numri të konsiderueshëm inspektimesh monitoruese për të drejtat e emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë, duke rekomanduar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore, duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të emigrantëve shqiptarë dhe respektimin rigoroz të standardeve të BE-së.

Kuvendi kërkon që Avokati i Popullit për vitin 2019:

- Të rrisë angazhimin në ndjekjen e përmbushjes së objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Agjenda 2030, me fokus të veçantë në çështje të tilla si: buxheti gjinor, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, mbrojtja e konsumatorëve, detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushat përkatëse dhe/ose rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

- Të rrisë veprimtarinë e tij informuese dhe sensibilizuese lidhur me fushën e veprimtarisë së tij dhe rolin e institucionit.

- Të rrisë angazhimin e tij në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke rritur bashkëpunimin me organizatat homologe.

- Të publikojë rekomandimet e tij dhe t'i adresojë ato pranë institucioneve përgjegjëse dhe Kuvendit të Shqipërisë në kohë, dhe të informojë Kuvendin e Shqipërisë mbi ecurinë e zbatimit të tyre.

- Të ndjekë shkallën e zbatimit të rekomandimeve, arsyet përse rekomandimet nuk janë përmbushur ose nuk janë pranuar dhe të informojë institucionet përgjegjëse dhe Kuvendin e Shqipërisë për masat që duhet të marrë.

- Të krijojë dhe të bëjë publik, jo më vonë se 6-muaj nga data e miratimit të kësaj rezolute, një regjistër me ankesat/kërkesat e marra nga institucioni, si dhe të deklarojë statusin e tyre, duke respektuar rregullat e transparencës dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

Miratuar në datën 30.5.2019